



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok

Municipal Assembly Istog

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

Nr. 3	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	22.04.2026 në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut
Procesmbajtës:	Flora Bujupaj Asistente e Kryesuesit të Kuvendit
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Zenel Shatri, Faruk Kabashi, Liridona Lajçi, Arben Kabashi, Kaltrina Arifaj dhe Floriana Maxharraj.
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Kryetari i Komunës Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës Genc Ademaj, Drejtorët: Merita Muzliaj Bytyçi, Era Rexhaj, Driton Alihajdaraj, Agon Dreshaj, Dukagjin Hoxhaj, Naim Behlulaj, Abedin Kabashi, Artan Gegaj, Kushtrim Buleshkaj, Fisnik Shoshi, zyrtar administrativ: Jeta Balaj, Ardon Arifaj, Liliana Frrokaj Driton Marku OSBE.

Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar-Mars) të vitit 2026.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- përshëndeti të pranishmit, Konstaton 6 anëtarë të KPF-së janë prezent, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e mbledhjes. Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për mbledhjen e sotme. Prezanton rendin e ditës, Fton ekzekutivin si dhe anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim për rend dite?

Arben Kabashi, PDK – përshëndet te gjithë të pranishmit, e kam një sqarim, në mbledhjen e kaluar të Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi votuar që të jetë mbledhjen e ardhshme një pikë e rendit të ditës, themelimi i komisionit për formimin e këshillave të fshatrave pra është votuar që në muajin

prill të jetë pikë e veçantë. Dhe propozoj që të hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- në rregull, a ka edhe dikush diçka? Kryetari e ka fjalën.

Kryetari i Komunës, z Ilir Ferati- përshëndet të gjithë! Në mbledhjen e kaluar është miratuar Lista e Veçantë dhe e Përgjithshme e pronave të paluajtshme të komunës që do jepen në shfrytëzim për këtë vit, MAPL-ja e ka kthyer në rishqyrtim për shkak se ne është dashur që në listë ti sqarojmë edhe destinimet, kështu që propozoj që kjo pikë të futet në rend dite për këtë mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- Pasi që nuk ka më diçka tjetër, hedh në votim propozimin e anëtarit Arben Kabashi, themelimi i komisionit për formimin e këshillave të fshatrave, kush është për?

Unanim me 6 vota për nga 6 anëtarë të KPF-së të pranishëm votohet që ky propozim të futet si pikë në rend dite për mbledhjen e sotme.

Hedh në votim edhe propozimin e kryetarit, Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Listës së përgjithshme dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës së Istogut që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026. Kush është për?

Unanim me 6 vota për nga 6 anëtarë të KPF-së të pranishëm votohet që propozimi i kryetarit të futet si pikë në rend dite për mbledhjen e sotme.

Hedh në votim Rendin e ditës

Kush është që të miratohet rendi i ditës.

Unanim me 6 vota për aq sa janë të pranishëm,

Miratohet rendi i ditës për mbledhjes e sotme.

Prezent në mbledhje janë gjashtë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vendimet:

Miratohet unanim rendi i ditës.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 2:

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova - vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës, a ka dikush diçka në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? Hap debatin, fjalën e ka Zenel Shatri.

Zenel Shatri, LDK- përshëndet të gjithë të pranishmit! Dua të pyes a shkruhen të gjitha fjalët në procesverbal apo jo? Sepse aty po mungonte se çfarë kam biseduar unë.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- Zenel në mandatin e kaluar është kërkuar nga disa kolegë tonë që të shkruhet fjalë për fjalë, por ajo kalon në transkriptë, ne kemi procesverbal dhe bëhet një përmbledhje. Fjalën e ka Arben Kabashi. Ndoshta nga incizimi kalon ndonjë pjesë dhe më mirë që mos të shkruhet kur nuk dinë se çfarë keni folur sesa të shtrembërohen fjalët.

Arben Kabashi, PDK- as unë nuk jam që të shkruhet krejt por jo të hiqet e gjithë fjalja.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- hedh në votim procesverbalin, kush është për?

Pasi që diskutime nuk pati shumë

Unanim miratohet procesverbali me 6 vota për, aq sa janë anëtarë të pranishëm.

Prezent në mbledhje janë gjashtë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vendimet:

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- po vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar-Mars) të vitit 2026. Së pari i japim fjalën kryetarit.

Prezent në mbledhje janë shtatë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Qendrim Ibrahimaj, ZKF-përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton pikën e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- fjalën e ka Arben Kabashi.

Arben Kabashi, PDK- krahasimi i shpenzimit prej të hyrave vetanake ky vit me tremujorin e vitit të kaluar sa është?

Qendrim Ibrahimaj, ZKF- krahasim nuk ka përderisa nuk janë alokuar mjetet e të hyrat vetanake deri në fund të muajit mars. Ajo çfarë po thua të është pjesa e realizimit.

Arben Kabashi, PDK- te të hyrat vetanake e e ke diku nën 30%, kemi të hyra më pak se tremujorin e vitit të kaluar.

Qendrim Ibrahimaj, ZKF- ndryshon përqindja sepse në total është 3.99% më pak se vitin e kaluar. Janë të dhëna që më dërgohen më vonë dhe për shkak se materialin më është dashur ta sjellë me kohë, raporti është korrigjuar dhe besoj që për Kuvend është i gatshëm.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- -a ka edhe dikush diçka. Pasi që jo vazhdojmë.

Rekomandojmë që të kalohet në Kuvend

Shtatë anëtarë prezent në mbledhje.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për Shqyrtim raportin financiar për tre mujorin e parë (Janar-Mars) të vitit 2026.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës. Themelimi i komisionit për formimin e këshillave të fshatrave. Pasi diskutime nuk ka, hedh në votim, kush është për?

Miratohet pika e rendit të ditës

Unanim me 7 vota për aq sa janë të pranishëm,

Prezent në mbledhje janë shtatë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim pikën ' Themelimi i komisionit për formimin e këshillave të fshatrave.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 5.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Listës së përgjithshme dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës së Istogut që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026. Kryetari e dha arsyetimin, shumë komuna kanë proceduar si vitet e mëparshme, disa kritere i kanë ndërruar. Është çështje puro teknike, dhe lus drejtorin përkatës që sa më shpejt të dërgojnë materialin edhe pse duhet të ju kërkoj mirëkuptim të gjitha partive politike sepse ka material voluminoz. Fjalën e ka Arben Kabashi.

Arben Kabashi, PDK- vendimi a është kthyer prej MAPL-së?

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- po është kthyer në rishqyrtim.

Nënkryetari i Komunës, Genc Ademaj- për të gjithë anëtarët e Kuvendit se lista e përgjithshme dhe e veçantë të dyja kanë shkuar njëjtë sikur vitin e kaluar, tani e e kanë qit një rregull të ri që po kërkojnë specifikim për secilën pronë. T'i mundesh me i fut dhjetë prona për dhënie në shfrytëzim por nuk e di mënyrën e investimit çfarë ka me qenë. Është praktikë që nuk është zbatuar asnjëherë. Po tejkalohet pak edhe kompetenca e MAPL-së këtë është mirë me e ditë të gjithë. Nëse është interesi i Kuvendit me i dhënë këto prona në shfrytëzim, ky rregull dhe ky arsyetim kanë me e vështirësuar dhënien në shfrytëzim. Vazhdon sqarimin.

Kryetari i Komunës, Ilir Ferati- një sqarim shtesë. Ekziston një dokument që quhet Hartë Zonale dhe ligjshmëria e të cilës është konfirmuar nga MAPL-ja. Te pothuajse 99% e parcelave të komunës së Istogut figuron edhe destinimi i tyre, a zonë bujqësore a turistike, a prodhuese, destinim që e ka aprovuar Ministria. E çka po lexoj prej arsyeshmërisë është politike bërje për shkak se ta pamundëson dhënien në shfrytëzim. Ne as nuk e dimë kohën, as kërkesën është e pamundur me e parashikuar ne si ekzekutiv natyrën e kërkesës që ka me ardhë. Harta Zonale është dokumenti që na e arsyeton këtë.

Faruk Kabashi, LDK- përrshëndet të gjithë! Destinimi i këtyre parcelave a duhet me u specifikuar vetëm një destinim apo ka mundësi të njëjtën parcelë mu jap për destinim me qenë tri-katër aktivitete me u bërë në ato parcela? Duke u bazuar edhe në Hartë Zonale.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- e thanë edhe kryetari edhe nënkryetari që ne nuk e dimë

gjithçka çfarë do të bëhet, këto mund t'i dimë kur të nënshkruhet kontrata.

Faruk Kabashi, LDK- nuk më kuptove, kur ti qesim në ankand a mundemi mi qit p.sh që mundet me u ushtruar ky aktivitet, apo ky, apo tjetri pra diku 5-6 aktivitete.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- e tha kryetari është e pamundur me i qit paraprakisht.

Faruk Kabashi, LDK- atëherë ne qenkemi para aktit të kryer, po i qesim ashtu siç janë.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- a ka edhe dikush diçka, pasi jo. Hedh në votim, kush është për?

Miratohet pika e rendit të ditës

Unanim me 7 vota për aq sa janë të pranishëm,

Prezent në mbledhje janë shtatë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF –ja unanim miratoj dhe, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim Rishqyrtimin i Vendimit për miratimin e Listës së përgjithshme dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës së Istogut që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Kryesuesi i kuvendit, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj : 10:39

Procesmbajtëse,
Znj. Flora Bujupaj



Kryesuesi i Kuvendit,
z. Enver Rugova

